

VENDIM
Nr. 61, datë 3.2.2017

PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE TË RIMBURSUESHME
(Ndryshuar me VKM nr. 814, datë 29.12.2017; nr. 318, datë 15.5.2019; nr. 229, datë 13.4.2022; nr. 58, datë 1.2.2023; nr. 492, datë 24.7.2024; nr. 348, datë 19.6.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paketa e pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, si pjesë e paketave të shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Lista e pajisjeve mjekësore hartohet nga komisioni teknik i listës së pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, i cili ngrihet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit.

3. Komisioni përfshin në listën e pajisjeve të rimbursueshme, pajisje të cilat janë të regjistruara dhe plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore.

4. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda datës 30 shtator të çdo viti, i dërgon Ministrisë së Shëndetësisë, listën e pajisjeve mjekësore të importuara dhe të prodhuara gjatë vitit kalendarik, si dhe subjektet përkatëse importuese e prodhuese.

5. Ministri i Shëndetësisë, brenda datës 15 tetor të çdo viti, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave çmimet e deklaruar nga subjektet importuese të regjistruara të pajisjeve mjekësore gjatë vitit kalendarik.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda 20 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për informacion, dërgon pranë Ministrisë së Shëndetësisë çmimet e deklaruar nga importuesit dhe prodhuesit e regjistruar të pajisjeve mjekësore gjatë vitit kalendarik.

7. Ministria e Shëndetësisë i dërgon Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor informacionin për pajisjet mjekësore, importuesit dhe prodhuesit, si dhe çmimet e importit, të mbledhura nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore e Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti.

8. Lista e pajisjeve mjekësore, e përfunduar nga komisioni, i paraqitet për miratim Këshillit Administrativ të Fondit.

9. Marzhet e tregtimit me shumicë dhe pakicë në rrjetin e hapur farmaceutik, si dhe marzhet e tregtimit të rrjetit spitalor, përcaktohen çdo vit, bashkë me listën përkatëse vjetore.

9.1. *Lista e pajisjeve mjekësore (fisha diabeti), që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për pacientët e grup-moshës 0–25 vjeç dhe nga 65 vjeç e më shumë, si dhe invalidët e punës dhe personat me aftësi të kufizuar të grup-moshës 25–65 vjeç është sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

9.2 *Marzhet e tregtimit me shumicë dhe pakicë për listën e pajisjeve mjekësore (fisha diabeti) të rimbursueshme, sipas shtojcës bashkëlidhur, janë përkatësisht 5.5% dhe 13%.*

9.3 *Paketat e trajtimit të stomës, që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

10. Lista e pajisjeve mjekësore të rimbursuara, e miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit, i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë për të vijuar procesin e miratimit pranë Këshillit të Ministrave.

11. Për vitin 2017, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, do të dërgojnë informacionin e përcaktuar në këtë projektvendim në Ministrinë e Shëndetësisë, brenda datës 28 shkurt 2017.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

SHTOJCA NR. 1

**LISTA E PAJISJEVE MJEKËSORE (FISHA DIABETI) TË RIMBURSUESHME,
QË TREGTOHEN NË FARMACITË E RRJETIT TË HAPUR**

(Shtuar me VKM nr. 814, datë 29.12.2017; ndryshuar me VKM nr. 318, datë 15.5.2019 dhe nr. 229, datë 13.4.2022; zëvendësuar me VKM nr. 58, datë 1.2.2023; ndryshuar me VKM nr. 492, datë 24.7.2024)

SHTOJCA NR. 1

Nr.	Emri i Pajisjes	Emërtimi i pajisjes sipas Regjistrit të AKBPM	Njësia	Prodhuesi	Çmimi reference (me TVSH)	Rimbursimi
1	Fishë diabeti	Blood Glucose monitoring system TD-4116; Blood Glucose Test Strip TD-4302	Kuti x 50 fisha	TaiDoc Technology Corporation B1-7F, No. 127, Wugong 2nd Road, Wugu Dist., 24888 New Taipei City, TAIWAN	564.7	100%
2	Fishë diabeti	VivaChek Ino Blood Glucose Test Strips	Kuti x 50 fisha	VivaChek Laboratories, Inc. 913 N Market Street, Suite 200 Wilmington, DE 19081 USA	642.7	87.9%
3	Fishë diabeti	On Call® Plus Blood Glucose Monitoring System; On Call® Plus Blood Glucose	Kuti x 50 fisha	ACON Laboratories, Inc. 5850 Oberlin Drive, #340 San Diego, CA 92121 USA	664.4	85%

		Strip; On Call® Plus Glucose Control Solution				
4	Fishë diabeti	Blood Glucose Meters; Blood Glucose Meters; Blood Glucose Test Controls	Kuti x 50 fisha	Hangzhou Sejoy Electronics & Instruments Co., Ltd. Building 2, No. 202, Zhenzhong Road West Lake Economy & Technology Zone 310030 Hangzhou China	697.6	80.9%
5	Fishë diabeti	Okmeter direct glucometer Blood Glucose Monitoring System: Including Blood Glucose Meter, Blood glucose test Strips & Control Solution, Model: OK-1NX (x=blank, J)	Kuti x 50 fisha	OK Biotech Co., Ltd. No.91, Sec. 2, Gondao 5th Road 30070 Hsinchu City, Taiwan	748.7	75.4%
6	Fishë diabeti	ARIA - Meter, strips and controls for the determination of Glucose in whole blood	Kuti x 50 fisha	Biochemical Systems International S.p.A Localita Palazzo del Pero 23, 52100, Arezzo, Itali	786.8	71.8%
7	Fishë diabeti	Blood Glucose Monitoring System : eBsugar	Kuti x 50 fisha	Visgeneer Inc. No. 335, Sec. 6, Zhonghua Rd. 30094 Hsinchu City, Taiwan	841.2	67.1%
8	Fishë diabeti	Exactive Vital Glucose meter; Glucose Test Strip	Kuti x 50 fisha	Microtech Medical (Hangzhou) Co., Ltd No. 9 Haishu Rd., Yuhang District Hangzhou 311121 Zhejiang	1072.9	52.6%

China						
9	Fishë diabeti	Accu-Chek Active (Model GB)mg/dL Kit-07133766; Accu-Chek Active test strips-07124112; Accu-Chek Active Control-03146324;	Kuti x 50 fisha	Roche Diabetes Care GmbH Sandhofer Strasse 116 68305 Mannheim GERMANY	1345.9	42%
10	Fishë diabeti	Blood Glucose Test Strip - EGS-2003 iHealth Glucose Test Strips Box (2*25 pcs)	Kuti x 50 fisha	Andon Health CO., Ltd. No. 3Jinping Street, YaAn Road, Nankai District Tiannjin, 300190 China	1376.2	41%
11	Fishë diabeti	Contour Plus blood glucose monitoring system,consisting of: Contour Plus Blood Glucose Meter;Contour Plus Blood Glucose Test Strips;Contour Plus Controls	Kuti x 50 fisha	Ascensia Diabetes Care Holdings AGPeter Merian-Strasse 90, 4052 Basel, Switzerland	1379.5	40.9%
12	Fishë diabeti	Accu-Chek Active Instant mg/gl Kit-07819307; Accu-Chek Active Instant test strips-07819382; Accu-Chek Instant Control-07869525; Accu-Chek Performa test strips-06454011; Accu-Chek Active (Model NC)mg/dL Kit-06987788;	Kuti x 50 fisha	Roche Diabetes Care GmbH Sandhofer Strasse 116 68305 Mannheim GERMANY	1514.1	37.3%
13	Fishë diabeti	OneTouch® Slect Plus Blood	Kuti x 50 fisha	LifeScan Europe GmbH	1598.2	35.3%

		Glucose Monitoring System; OneTouch Select Plus Flex™ Blood Glucose Monitoring System (Serial Number prefixed with G')		Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland		
14	Fishë diabeti	Blood Glucose Test Strip: Rightest GS550	Kuti x 50 fisha	Bionime Corporation No. 100, Sec. 2, Daqing St., South Dist., Taichung City 40242, Taiwan	1620.1	34.9%
15	Fishë diabeti	Blood Glucose Monitoring Systems: Safe AQ Smart Blood Glucose Meter; Safe AQ Air Blood Glucose Meter; Safe AQ Voice Blood Glucose Meter; Safe AQ Blood Glucose Test Strip; Blood Glucose Control Solution.	Kuti x 50 fisha	Changsha Sinocare Inc. No.265 Guyuan Road, Hi-tech Zone, Changsha, Hunan Province, 41025, PR of China	1831.1	30.8%

* Kompanitë importuese do të sigurojnë dhënien falas të aparateve për matjen e glicemisë, si dhe gjilpërave shpuese për çdo përfitues të fishave të diabetit.

(Shtuar shtojca 2 me VKM nr. 348, datë 19.6.2025)

SHTOJCA 2

PAKETAT E TRAJTIMIT TË STOMËS TË RIMBURSUARA, QË TREGTOHEN NË FARMACITË E SPITALEVE

Paketa e trajtimi të kolostomës	Kosto në lekë	Marzhi i fitimit në përqindje	Çmimi i paketës	Prodhuesi
<i>Në këtë paketë përfshihen:</i>	13,400	5.5%	14,100	Welland Medical Ltd, Hydehurst Lane, Crawley, Eest Sussex, RH 10, 9AS, United Kingdom
Sistem nje-pjesesh kolostomie pa shkarkim				Vitaimed Instrument CO. LTD, No1, nanmatou Road Putong New district 200125, Shanghai, China
ose				Lentismed d.o.o Slavonska avenija, 26/9, 10000 Zagreb, Croatia
Sistem dy-pjesesh, qese kolostomie pa shkarkim dhe Sistem dy-pjesesh, baza standarte				Oxmed International GmbH, Groendeahlscher Weg 87, 46446, Emmerich am Rhein, Germany
Spraj për heqjen e adezivit				
Paste Barrier	14,500	5.50%	15,300	Wuhan Sitaili Medical Apparatus Development/China

Paketa e trajtimi të urostomës	Kosto në lekë	Marzhi i fitimit në përqindje	Çmimi i paketës	Prodhuesi
<i>Në këtë paketë përfshihen:</i>	12,300	5.5%	13,000	Welland Medical Ltd, Hydehurst Lane, Crawley, Eest Sussex, RH 10, 9AS, United Kingdom
Sistem nje-pjesesh urostomie me shkarkim				Vitaimed Instrument CO. LTD, No1, nanmatou Road Putong New district 200125, Shanghai, China
ose				Lentimed d.o.o Slavonska avenija, 26/9, 10000 Zagreb, Croatia
Sistem dy-pjesesh, qese urostomie me shkarkim dhe Sistem dy-pjesesh, baza standarte				Oxmed International GmbH, Groendeahlscher Weg 87, 46446, Emmerich am Rhein, Germany
Spraj per heqjen e adezivit				
Paste Barrier				
	13,100	5.50%	13,800	Wuhan Sitaili Medical Apparatus Development/China

Paketa e trajtimi të ileostomës	Kosto në lekë	Marzhi i fitimit në përqindje	Çmimi i paketës	Prodhuesi
<i>Në këtë paketë përfshihen:</i>	13,400	5.5%	14,200	Welland Medical Ltd, Hydehurst Lane, Crawley, Eest Sussex, RH 10, 9AS, United Kingdom
Sistem nje-pjesesh ileostomie me shkarkim				Vitaimed Instrument CO. LTD, No1, nanmatou Road Putong New district 200125, Shanghai, China
ose				Lentismed d.o.o Slavonska avenija, 26/9, 10000 Zagreb, Croatia
Sistem dy-pjesesh, qese ileostomie me shkarkim dhe Sistem dy-pjesesh, baza standarte				Oxmed International GmbH, Groendeahlscher Weg 87, 46446, Emmerich am Rhein, Germany
Spraj per heqjen e adezivit				
Paste Barrier	14,550	0	15,350	Wuhan Sitaili Medical Apparatus Development/China